



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-65511 dt. 22/12/2022

Në bazë të nenit 43, pika 43.1, 44, 44.1, 44.2 dhe 44.3, të Ligjit nr. 03/L-40, për vetëqeverisje Lokale, neni 6, pika 1, të Udhëzimit Administrativë (MAPL) Nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, dhe në bazë të kërkesës së Kryetarit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **28.12.2022**, (ditë e Mërkurë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02. Nr. 464/01-18364 të datës 27.04.2022, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
2. Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023.
3. Plani vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023.
4. Plani Komunal për Integritet 2023-2026.
5. Lista e rreziqeve Komunale për vitin 2023.
6. Propozim vendim për emërtimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NLP) në Drenas.
7. Informimi i Kuvendit për aktivitetet e KKSB-së për gjashtë mujorin e dytë.
8. Propozim vendim për miratimin e raportit të komisionit komunal përfundimtar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Drenas, 22.12.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Ramiz Lladrovci

Thu 2022-12-22 2:32 AM

Show all 15 recipients

To: ☐ Milaim Hajdari;

Cc: ☐ Drenasi.Deputetet; ☐ Qendrim Mulaj;
☐ Egzona Tërdevci; ☐ Mirlinda.Dvorani@pak-ks.org;
☐ Labinot Halilaj; ☐ Kujtim Aliu; ☐ Gëzim Sahiti; ...

You forwarded this message on 2022-12-22 2:34 AM.

I nderuar Kryesues z. Hajdari,

Në bazë të paragrafit 1 dhe 3 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 44 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara me nenin 72 të Statutit të Komunës së Glllogocit (Drenasit), kërkojë që me datë 28.12.2022, duke filluar nga ora 10:00, të mbahet seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Glllogocit (Drenasit), dhe për seancë propozoj këto pika për rendin e ditës:

1. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 02 Nr.464/01-18364, të datës 27.04.2022 të Kuvendit të Komunës së Drenasit;
2. Plani i Punës se Kuvendit Komunal për vitin 2023;
3. Plani vjetor i punës se Kryetarit të Komunës për vitin 2023
4. Plani Komunal për Integritet 2023-2026;
5. Lista e rreziqeve Komunale për vitin 2023;
6. Propozim vendim për emërtimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NLP) ne Drenas;
7. Informimi i Kuvendit për aktivitetet e KKS-së për gjashtë mujorin e dytë;
8. Propozim vendim për miratimin e raportit të komisionit komunal përfundimtar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Kjo mbledhje e jashtëzakonshme thirret për faktin se e kemi të pamundur që në muajin dhjetor të mbahet mbledhje e rregullt e Kuvendit të Komunës, ndërsa të gjitha pikat e propozuara për seancën e jashtëzakonshme janë të rëndësishme për Grantin e Përformacës, pra mbajtja e kësaj mbledhje është në të mirë të zhvillimit dhe investimeve për qytetaret e komunës sonë.

Të gjitha materialet për pikat e propozuara për rendin e ditës do të përcjellën në sekretarinë e Kuvendit në formë fizike

Me respekt

On 21 Dec 2022, at 15:10, Milaim Hajdari <Milaim.Hajdari@rks-gov.net> wrote:



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT



Zyra e Kryetarit

01 Nr. 464/01 64183 . dt. 14.12 .2022

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, si dhe në bazë të vendimit të ligjshmërisë nga MPL Nr.VI- 020.372/8 të datës 27.05.2022, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022 të miraton këtë:

PROPOZIM – VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 02 NR.464/01-18364 TË DATËS 27.04.2022, TË
KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT

I.

Të Shfuqizohet Vendimi 02 Nr.464/01-18364 të datës 27.04.2022 të Kuvendit të Komunës për Shpronësimin e njësive të ndërtesave – banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën Kadastrale në Gllogoc.

II.

Bazë për shfuqizimin e këtij vendimi është Kërkesa e MPL-së Nr VI.020-372/8, datë 27.05.2022, për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit të Komunës së Gllogocit 12 Nr.464/01-18364 të datës 27.04.2022 për Shpronësimin e njësive të ndërtesave – banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën Kadastrale në Gllogoc.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

IV.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

KRYETARI I KOMUNËS:

Ramiz Lladrovci



Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 27.04.2022 ka miratuar Vendimin 12Nr.464/01-18364 për Shpronësimin e njësive të ndërtesave – banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën Kadastrale në Gllogoc.

Por MPL në vlerësimin për ligjshmëri Nr.VI -020-372/8 të datës 27.05.2022, ka përcjellur vlerësimin e Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.04-2551-3/22, dt.27.05.2022, me të cilin vlerësim Vendimin 12Nr.464/01-18364 për Shpronësimin e njësive të ndërtesave – banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën Kadastrale në Gllogoc, është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Andaj Kuvendi i Komunës së Drenasit do të rishqyrtoj edhe do të harmonizoj këtë vendim sipas kërkesës së MPL-së/MMPHI-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



02 Nr. 464/01-18364 dt. 27.04.2022

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, në bazë të nenit 4, 7 dhe 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Ligji nr. 03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, si dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit, 12 Nr. 462/01-47383 dt. 30.10.2020 dhe ligjshmërisë së këtij Vendimi nga MPL nr. VI 020-828/8 dt. 16.11.2020, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.04.2022, miraton këtë:

V E N D I M

Për Shpronësimin e njësive të ndërtesave - banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.

Neni 1.

Vendimi i Kryetarit të Komunës për Shpronësimin e Njësive të Ndërtesave - Banesave të cilat janë të ndërtuara në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.

Neni 2.

Shpronësimi i këtyre pronave ka për qëllim realizimin e interesit publik të Komunës së Drenasit konkretisht realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.

Neni 3.

Njësitë e Ndërtesave - Banesave që do të shpronësohen kanë këto karakteristika:

- 1- Njësia e ndërtesës nr. O-70315016-24-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues (bashkëposesues) Drita (Muhamet) Baleci Glllogoc 3/5, Jeton (Muhamet) Hoxha Glllogoc 2/5.
- 2- Njësia e ndërtesës nr. O-70315016-00743-1-23-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Ruzhdi (Haki) Hoxha Glllogoc.
- 3- Njësia e ndërtesës nr. O-70315016-23-2-1-0 me sipërfaqe prej 59.28m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Afrim (Ujkan) Hysenaj Glllogoc.
- 4- Njësia e ndërtesës nr. O-70315016-21-2-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Gani (Ilaz) Hoxha Glllogoc.
- 5- Njësia e ndërtesës nr. O-70315016-00743-1-20-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Xhyla (Ramadan) Halilaj Glllogoc.
- 6- Njësia e ndërtesës nr. O-70315016-21-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Murtez (Rizah) Zogu Glllogoc.
- 7- Njësia e ndërtesës nr. O-70315016-24-2-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Arsim (Hasan) Gashi Glllogoc.
- 8- Njësia e ndërtesës nr. O-70315016-26-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Fadil (Jahir) Haxhiu.

- 9- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-27-3-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Musli (Myrtë) Haxhiu Glllogoc.
- 10- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-00743-1-20-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Shpetim (Idriz) Morina 1/2 dhe Shkumbin (Idriz) Morina 1/2.
- 11- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-22-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Hysri (Rama) Morina.

Neni 4

Vlera e kompensimit për banesat që do të shpronësohen do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit i cili do të inicon procedurën e mëtejme për shpronësim të objekteve banesore të cilat ndodhen në zonën kadastrale në Glllogoc.

Neni 6

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale që nevojiten për shpronësimin e këtyre njësive të ndërtesave-banesave.

Neni 7

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit/Glllogocit.

Neni 8.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit





05.05.2022
02 070/01-19621

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit



DATE:	05.05.2022
NUMËR:	
PËR/ZA/TO:	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Prishtinë
PËRMES:	Kryetarit të Komunës së Glllogocit, Ramiz Lladrovci
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Glllogocit, Drejtore Mutara Agushi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë për pajtueshmërinë e dokumentit të planifikimit hapësinor- Planin Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2022-2028

Të nderuar,

Lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit 12-Nr.464 01-18364 për shpronësimin e njësjve të ndërtesave-banesave, në parcelën kadastrale nr.743-30 në zonën kadastrale në Glllogoc të miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Glllogocit me datë 27.04.2022.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ka dhënë sqarime bazike, të cilat sqarime i referohen dokumenteve aktuale valide të planifikimit hapësinor përkatësisht, Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028 (i miratuar me vendim të kuvendit komunal 12-Nr 400/01-28767 të datës 30.07.2020).

Për informimin tuaj, duke theksuar se, Plani Zhvillimor Komunal i Glllogocit 2020-2028 (I hartuar sipas Ligjit 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ 08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor) përmban kornizën e zhvillimit hapësinor por nuk përcakton konkretisht kushte zhvillimore për parcela të caktuara, por përqendrohet në dispozitat e përgjithshme për zbatim, duke u mbështetur në:

KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR
ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE - SEKTORI I BANIMIT

Qëllimi 2: Plotësimi i nevojave për banim

Objektiva 2.2. Rritja e fondit të banimit të përballueshëm për 50%.

Bazuar në elaborimin e lartëshënuar mbi bazueshmërinë, përputhshmërinë dhe mbulueshmërinë me Planin Zhvillimor Komunal si dhe trajtimin e lokacionit/parcelës aktuale në aspektin e ndërlidhjes konstatohet se, kjo parcelë kadastrale hynë brenda kufirit ndërtimor-urban e paraparë sipas Planit Zhvillimor Komunal.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe mbrojtje të Mjedisit konstaton se, kjo zonë është e paraparë dhe në pajtim me dokumentin e planifikimit hapësinor - Planin Zhvillimor të Komunës.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gillogocit Milaim Hajdari, Kryesuesi e Kuvendit të Komunës së Gillogocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Verëra Çerkini, Zëvendësuesi e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësta për Administratën e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPH Servet Spahiu, Zëvendësuesi e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit të Ligjvënies Prizren, 05.05.2022
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Zbatimit të Ligjeve dhe Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve
2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Rregullores Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënde:	Vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.464/01-18364 për shpronësimin e njësisë të nderiesave - banesave në parcelën nr.743-30 në zonën kadastrale në Gillogoc

I nderuari, Kryetar, Lladrovci,
I nderuar Kryesues, Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave më datë 04.05.2022, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr.464/01-18364 për shpronësimin e njësisë të nderiesave - banesave në parcelën nr.743-30 në zonën kadastrale në Gillogoc, miratuar me datë 27.04.2022 nga KK Gillogoc.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Gillogocit:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendimi Nr.464/01-18364 për shpronësimin e njërive të ndërtesave – banesave në parcelën nr.743-30 në zonën kadastrale në Glogoc, miratuar nga KK Glogoc, pasi që i njëjti është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, vlerëson se vendimi Nr.464/01-18364 për shpronësimin e njërive të ndërtesave – banesave në parcelën nr.743-30 në zonën kadastrale në Glogoc, miratuar nga KK Glogoc, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronësive Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/ L-205 të datës 28 tetor 2010 .

Sipas Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronësive Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/ L-205 të datës 28 tetor 2010 vetëm një Organ Shpronësues i përcaktuar në nenin 3 paragrafi 1 të këtij Ligji ka të drejtë të bëjë shpronësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Kosovës.

Sipas nenit 4, paragrafi 2 Organ shpronësues në nivelin lokal është Kryetari i Komunës.

Kompetencat e Kryetarit të Komunës për shpronësim të pronave të paluajtshme brenda territorit të Komunës dhe për interes komunal janë të përcaktuara në nenin 4 paragrafi 2 si më poshtë:

2. Organi Shpronësues i Komunës është Kryetari i Komunës, përveç nëse kuvendi komunal i komunës përkatëse, përmes një akti të miratuar në përputhje me nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, cakton një Autoritet tjetër Publik Komunal për të vepruar në cilësinë e Organit Shpronësues të Komunës. Organi Shpronësues i Komunës mund bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm nëse:

2.1. kushtet e përcaktuara në paragrafit 1. të këtij neni;

2.2. shpronësimi i prek shprehimisht të drejtat private në fushëveprimin e paragrafit 3. të nenit 3 të këtij ligji;

2.3. prona e paluajtshme përkatëse gjendet plotësisht brenda kufijve të Komunës; dhe

2.4. shpronësimi ndërlikohet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë me arritjen e njërit nga qëllimet publike në vijim:

2.4.1. zbatimin e një plani urbanistik dhe/ose hapësinor i cili është miratuar dhe shpallur nga një Autoritet Publik Komunal në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;

2.4.2. ndërtimin ose zgjerimin e një ndërtese ose objekti i cili i do të shfrytëzohet nga një Autoritet Publik Komunal për ushtrimin e funksionit të tij publik; ose

2.4.3. ndërtimin, zgjerimin, themelimin ose vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve në vijim, nëse kjo është e nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të komunës ose ka një përfitim tjetër të qartë publik për banorët e komunës dhe është në përputhje me kushtet e aplikueshme ligjore;

2.4.3.1. rrugët komunale (rrugët të cilat shtrihen tërësisht brenda Komunës) të cilat ofrojnë shërbime të transportit për publikun;

2.4.3.2. objektet publike të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për sigurimin e shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe/ose të mirëqenies sociale brenda Komunës;

2.4.3.3. gypat që përdoren për sigurimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për vendbanimet brenda Komunës;

2.4.3.4. deponitë komunale dhe vendet për deponimin e mbeturinave publike;

2.4.3.5. varrezat publike komunale; ose

2.4.3.6. parqet publike komunale dhe objektet publike komunale të sportit; ose

2.4.4. përvetësimin e të drejtave sipërfaqësore të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për zbatimin e një licence të shfrytëzimit zejtar të mineraleve e cila i është dhënë Komunës nga KPMM në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Në bazë të gjithë kësaj që parashef Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Kryetari i Komunës nxjerr vendime me të cilat propozon inicon dhe kryen procedura të shpronësimit për interes komunal të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 4.

Pra kompetencë për kryerjen e procedurës së shpronësimit të pronave private brenda territorit të Komunës, ka vetëm Kryetari i Komunës dhe të gjitha Vendimet për shpronësim nënshkruhen vetëm nga Kryetari i Komunës si Organ Shpronësues:

1. Vendimi për shqyrtimin e mëtejshëm të Kërkesës për Shpronësim
2. Vendimi Preliminar për ligjshëmërinë e procesit të shpronësimit
3. Vendimi Përfundimtar i cili përban shumën e kompensimit të pronës të caktuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Sa i përket Vendimeve që nxjerr Kuvendi Komunal dhe nënshkruhen nga Kryesuesi i Kuvendit përgjigjen e vlerësimit të ligjshmërisë duhet t'a japë Ministria e Administrimit të Pashetit Lokal.

Gjithashtu, nga ju kemi pranuar shkresën me informata shtese, në këto shkresa janë prezantuar disa nga informatat shtesë, mirëpo, gjatë shqyrtimit të këtyre informatave, nuk saktësohet qëllimi i shpronësimit ndaj këtyre njësive të banimit, vetëm thuhet se qëllimi i shpronësimit të këtyre njësive të banimit është implementimi i Planit Zhvillimor Komunal por jo edhe çfarë parshihet me këtë dokument, cili është qëllimi i saktë i shpronësimit të njësive të banimit, çka planifikohet të ndërtohet në këtë lokacion.

Po ashtu, në shkresat e lëndës nuk është prezentuar ndonjë marrëveshje paraprake e organit kompetent komunal me pronaret e njësive të banimit, se cka do të ndodhë me këto familje pasi që pas çdo procesi të shpronësimit munde të krijohen raste sociale.

Andaj, nga ajo që u tha më lartë, rekomandojmë që të konsultohet edhe Ligji Nr. 04/L-061 për shirjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

Të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqji, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

RE: Shkresa e dergimit të akteve të miratuara në mbledhjen e rregullt të KK të dt. 27.04.2022

15331

Shkrimorja Mapl

Zahrie Podrimqaku <zahrie.podrimqaku@rks-gov.net>

Konfirmoj.

From: Zahrie Podrimqaku

Sent: Wednesday, April 27, 2022 3:50 PM

To: Shkrimorja Mapl; Gëzim Sahiti; Kujtim Aliu; Vjosa Ahmetaj

Cc: Laureta Thaqi; Ramiz Lladrovci; Milaim Hajdari; Bekim Dobra; Liridona Ajazi; Erlona Gashi

Subject: Shkresa e dergimit të akteve të miratuara në mbledhjen e rregullt të KK të dt. 27.04.2022

Pjesa e dytë e vendimeve

From: Zahrie Podrimqaku

Sent: Wednesday, April 27, 2022 3:47 PM

To: Shkrimorja Mapl; Gëzim Sahiti; Kujtim Aliu; Vjosa Ahmetaj

Cc: Laureta Thaqi; Ramiz Lladrovci; Milaim Hajdari; Bekim Dobra; Liridona Ajazi; Erlona Gashi

Subject: Shkresa e dergimit të akteve të miratuara në mbledhjen e rregullt të KK të dt. 27.04.2022

Të nderuar/a

Në attach i keni të bashkangjitura aktet e miratuara të mbledhjes së KK për Ligjshmëri.

Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt : 27.04.2022, në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në MPL.

Pjesa parë

1. Vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
2. Vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave-banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.
3. Vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale nr.538/0 dhe 512/0 në zonën kadastrale në Nekoc
4. Vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988.
5. Vendim për bartjen e të hyrave vetanake.
6. Vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022
7. Vendim për rivedimin e Planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar.
8. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

12.07.2019

rk: Shkresa e dergimit te akteve te miratuara ne mbledh .. - Zanrie Podrimqaku

9. Propozim Vendim për lejimin e rrënimit të objekteve të vjetra shkollore në oborrin e shkollës SHFMU "Deshmoret e Drenicës" në Çikatovë të Vjetër dhe SHFMU "Abedin Bujupi" në Arllat.

-Ju lutem ma konfirmoni marrjen e dokumentav.

Me respekt!

Shelja e Zyrës së Kuvendit

Zahrie Podrimqaku Subashi

Tel:

03820040872

Mob; 049-977 973.

Emaili: Zahrie.podrimqaku@rks-gov.net



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-030/01-59464 dt. 14.11. 2022

PLANI I PUNËS
SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN
2023

Nëntor, 2022

PLANI I PUNËS

SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

Pasqyra e planit

Parathënie.....	02
Janar.....	05
Shkurt.....	06
Mars.....	07
Prill.....	08
Maj.....	09
Qershor.....	10
Korrik.....	11
Gusht.....	12
Shtator.....	13
Tetor.....	14
Nëntor.....	15
Dhjetor.....	16

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Punën dhe aktivitetin e vet e mbështet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Statutin e Komunës dhe akte të tjera nënligjore. Siguron kushte të punës për seanca të Kuvendit, si dhe pjesëmarrje për qytetarët gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve, për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe çdo gjë në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Kuvendi i Komunës nxjerr akte të rëndësishme për Komunën siç janë:

- Statuti i Komunës
- Rregullorja e Punës
- Rregulloret komunale dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim normal të komunës

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës kryen edhe funksione të tjera dhe detyra të pa deleguara:

- Miraton Planin Vjetor të Punës
- Themelon komisione sipas ligjit
- Merr vendime për krijimin dhe përdorimin e dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi
- Bën emërimin, riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike
- Arrin marrëveshje ndër komunale dhe brenda komunale
- Merr vendime për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës, si dhe përgjegjësit të tjera të përcaktuara me ligj.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Drenasit për vitin 2023

Plani i punës së Kuvendit ka për qëllim planifikimin paraprak të punës për vitin 2023 dhe i bashkërenditur me aktivitetet e Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023. Plani i Punës e përmbledh punën një vjeçare të Kuvendit, duke përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet, ndërsa çështjet të cilat nuk mund të planifikohen dhe dalin si nevoja për shqyrtim në Kuvend, do të trajtohen sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës së Drenasit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit. Në këtë mënyrë, në Planin e Punës janë paraparë 11 mbledhje të rregullta që do të mbahen për vitin 2023 mbledhjet do të mbahen javën e fundit të çdo muaji, përjashtimisht në rast kur mund të përcaktohet ndryshe.

Planifikimi i mbledhjeve të KK –së dhe çështjet që do të trajtohen gjatë vitit 2023

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

JANAR 2023

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti vjetor i buxheut për vitin 2022	DF	Kryetari i Komunës	12.01.2023	KPF 19.01.2023	26.01.2023	
2.	Raportet e Komiteteve Konsultative në KPF	Komitetet Konsultative	Kuvendi i Komunës	12.01.2023	KPF 19.01.2022	26.01.2023	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorinë Profesionale	Kryetari i Komunës	12.01.2023	KPF 19.01.2023	26.01.2023	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023
SHKURT 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti i Kryetarit të Komunës për vitin 2022.	Drejtoritë profesionale	Kryetari i Komunës	09.02.2023	KPF 16.02.2023	23.02.2023	17.02.2023
2.	Plani i veprimit për transparencë për vitin 2022.	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës		KPF 16.02.2023		MBLEDHJE SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR NDERË TË 17 SHKURTIT, DITËS SË SHPALLJES SË PAVARSISË SË KOSOVËS
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës		KPF 16.02.2023		
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

MARS 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend AKTIVITETET Afati kohor	05.03.2023
		Dytësor	Parësor				
1.	Plani i veprimt për transparence për vitin 2022	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	09.03.2023	KPF 16.03.2023	23.03.2023	Mbledhje Solemne e Kuvendit të Komunës Drenas kushtuar "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rënies Heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	09.03.2023	KPF 16.03.2023	23.03.2023	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

PRILL 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRÇJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti financiar për tre mujorin e vitit 2023	DF	Kryetari i Komunës	13.04.2023	KPF 20.04.2023	27.04.2023	Dita botërore e Tokës - 22 Prilli
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	13.04.2023	KPF 20.04.2023	27.04.2023	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

MAJ 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRÇJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraparak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITET ET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informmat lidhur me qarkoren Buxhetore 2023 dhe planifikimi i veprimit për dëgjime Publike	DF	Kryetari i Komunës	12.05.2023	KPF 19.05.2023	26.05.2023	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorinë Profesional e	Kryetari i Komunës	12.05.2023	KPF 19.05.2023	26.05.2023	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

QERSHOR 2023

Nr .	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Draft – komiza afatmesme buxhetore (KAB) për vitet 2023-2025	DF	Kryetari i Komunës	15.06.2023	KPF 22.06.2023	29.06.2023	MBLEDHJEN SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR NDERË TË 14 QERSHORIT, DITËS SË ÇLIRIMIT TË DRENASIT
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesional e	Kryetari i Komunës	15.06.2022	KPF 22.06.2023	29.06.2023	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

KORRIK 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti gjyashhtë mujor i Kryetarit të Komunës së Drenasit për vitin 2023	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.07.2023	KPF 20.07.2023	27.07.2023	
2.	Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2022 për Komunën e Drenasit (Glllogocit)		Kryetari i Komunës				
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës				
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

Gusht, 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGRJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
6.	Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës se Drenasit për vitin 2023	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	16.08.2023	KPF 23.08.2023	30.08.2023	
7.	Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2022 për Komunën e Drenasit (Glllogocit)		Kryetari i Komunës				
8.	Trajtimi i gëshfjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës				
9.							
10.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

SHTATOR 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGRJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraparak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti gjashtë mujor financiar i Komunës se Drenasit për vitin 2023	DF	Kryetari i Komunës	14.09.2023	KPF 21.09.2023	28.09.2023	
2.	Shqyrtimi i Draft -Buxhetit final, dhe marrja e vendimit për buxhet për vitet 2023-2025	DF	Kryetari i Komunës	14.09.2023	KPF 21.09.2023	28.09.2023	
3.	Trajtimi i gështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorit profesional	Kryetari i Komunës	14.09.2023	KPF 21.09.2023	28.09.2023	
4.							
5.							
6.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

TETOR 2023

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITET ET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti nëntë mujor i realizimit të buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2022	Drejtorië	Kryetari i Komunës	12.10.2023	KPF 19.10.2023	26.10.2023	
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorië	Kryetari i Komunës	12.10.2023	KPF 19.10.2023	26.10.2023	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023

NËNTOR 2023

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRSGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatë nga Drejtoria e Urbanizimit, Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit rreth realizimit të përfundimit të projekteve kapitale në teren	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	10.11.2023	KPF 17.11.2023	24.11.2023	28. Nëntor 2023 Seancë Solenne për nder të festes së Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	10.11.2023	KPF 17.11.2023	24.11.2023	
3.							
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2023 **DHJETOR 2023**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITE TËT Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022	Kryetari i Komunës	Kuvendi i Komunës	09.12.2023	KPF 15.12.2023	22.12.2023	
2.	Plani i Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022	Drejtoritë përkatëse	Kryetari i Komunës	09.12.2023	KPF 15.12.2023	22.12.2023	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	09.12.2023	KPF 15.12.2023	22.12.2023	

Kuvendi i Komunës së Drenasit ka planifikuar që gjatë vitit 2023, të mbajë gjithsej 12 mbledhje, këtij Plan i ja bashkëngjisim edhe orarin e takimeve që do të mbahen për secilin muaj.

DRENAS – 14.11.2022

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mila Him Hajdari



Janar Seanca e KPF-a me 19.01.2023 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK me 26.01.2023 E Enjte	Shkurt Seanca e KPF-a me 16.02.2023 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 23.02.2023 E Enjte	Mars Seanca e KPF-a me 17.03.2023 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 24.03.2023 E Enjte
Prill Seanca e KPF-a me 20.04.2023 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 27.04.2023, E Enjte	Maj Seanca e KPF-a me 19.05.2023, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 26.05.2023 E Enjte	Qershor Seanca e KPF-a me 22.06.2023, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 29.06.2023 E Enjte
Korrik Seanca e KPF-a me 20.07.2023, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 27.07.2023, E Enjte	Gusht Seanca e KPF-a me 23.08.2023, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 30.08.2023 E Mërkurë	Shtator Seanca e KPF-a me 21.09.2023, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 28.09.2023, E Enjte
Tetor Seanca e KPF-a me 19.10.2023 ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 26.10.2023, E Enjte	Nëntor Seanca e KPF-a me 17.11.2023, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 24.11.2023, E Premte	Dhjetor Seanca e KPF-a me 15.12.2023, ora 10:00 Seanca e Rregullt e KK-al me 22.12.2023, E Premte